Një veturë në veri refuzoi të ndalet, Policia detyrohet të shtijë me armë zjarri

KRONIKA March 09, 2023 - 22:36

SHPËRNDAJE:

Një veturë në fshatin Banje në veri të Mitrovicës, ka refuzuar urdhrat e Policisë së Kosovës për tu ndalur, pasi ishte duke kaluar në një rrugë ilegale.

This site

Sonte rreth orës 19:20, përderisa njësia policore e Policisë së Kosovës ndodhej në pikë kontrolli në fshatin Banje në një rrugë ilegale, duke realizuar detyrat dhe autorizimet e saj ligjore në garantimin e sigurisë, aty ka qarkulluar një automjet xhip i tipit "audi".

Policia ka sqaruar përmes një njoftimi se zyrtarët policor në pikë kontrolli sipas procedurave kanë sinjalizuar automjetin me bateri që të ndaloj për kontroll rutinor, por personi i dyshuar (drejtuesi i automjetit) posa ka vërejtur zyrtarët policor të cilët e kanë sinjalizuar për ndalim, ka rritur shpejtësinë për të ikur nga ndalimi duke rrezikuar drejtpërdrejt jetën e zyrtarëve policor, përderisa njëri nga zyrtarët policor me qëllim të shmangies së rrezikut të drejtpërdrejt për jetën e tij dhe zyrtarëve tjerë policor është detyruar që të përdor armën e zjarrit.

Njoftimi i plotë i Policisë:

Informacion lidhur me angazhimet e Policisë së Kosovë në rajonin e Mitrovicës veri

Prishtinë, 9 mars 2023

Më datë 9 mars 2023, rreth orës 19:20, përderisa njësia policore e Policisë së Kosovës ndodhej në pikë kontrolli në fshatin Banje në një rrugë ilegale, duke realizuar detyrat dhe autorizimet e saj ligjore në garantimin e sigurisë, aty ka ardhur/qarkulluar një automjet xhip i tipit audi.

Zyrtarët policor në pikë kontrolli sipas procedurave kanë sinjalizuar automjetin me bateri që të ndaloj për kontroll rutinor, por personi i dyshuar (drejtuesi i automjetit) posa ka vërejtur zyrtarët policor të cilët e kanë sinjalizuar për ndalim, ka rritur shpejtësinë për të ikur nga ndalimi duke rrezikuar drejtpërdrejt jetën e zyrtarëve policor, përderisa njëri nga zyrtarët policor me qëllim të shmangies së rrezikut të drejtpërdrejt për jetën e tij dhe zyrtarëve tjerë policor është detyruar që të përdor armën e zjarrit.

Automjeti i dyshuar me shpejtësi është larguar nga vendi i ngjarjes përmes rrugëve ilegale, përderisa njësitet policore janë duke ndërmarr veprime operative dhe hetimore për identifikimin dhe arrestimin e personit/ve të dyshuar të përfshirë në këtë rast.

Si vazhdimësi e hetimit gjatë realizimit të detyrave policore, njësitë relevante policore kanë ndaluar dy automjete tjera të cilat kanë ardhë në atë lokacion, e që dyshohet se mund të ndërlidhen me veturën e dyshuar, në te cilat vetura gjendeshin pesë persona, të cilët janë dërguar në stacion policor për intervistim dhe procedura të mëtejme në bashkëpunim dhe koordinim me organet e drejtësisë.

Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar në realizimin e detyrave dhe autorizimeve ligjore në parandalimin e veprave kriminale, ndërmarrjen e masave rigoroze ndaj secilit individ apo grup kriminal që cenon rendin, sigurinë apo rrezikon jetën e zyrtarëve policor që po punojnë natë e ditë për të garantuar sigurinë e qytetarëve tanë në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Taboola Feed

Kolltuk masazhues profesional - 73% zbritje! Vetëm 55 000 Lek

megazbritje.al | Sponsored

Data Science Courses Might Be Easier Than You Think

Data Science | Search Ads | Sponsored

Gjendet serbi i zhdukur, familjarët e tij i falënderojnë edhe shqiptarët që ndihmuan për kërkim

Ivan Millosheviq nga Beogradi, i cili ishte i zhdukur në Kosovë që nga 25 majo është gjetur sot. Këtë e bën të ditur familjarë të tij duke e dërguar një email në redaksinë...

Zeri.info

Online Marketing Courses Prices [2022-2023]

Digital Marrketing Course | Search | Sponsored

Të rekomanduara

Brenda 24 orëve, tri raste të falsifikimit të...

March 10, 2023

Prishtinasi e gjen një portofol me para e...

March 10, 2023

Vdes në QKUK gruaja që u aksidentua tre muaj më parë në Prizren

KRONIKA | March 10, 2023

Prishtinë: U përfshinë në një rrahje, në pranga dy persona

KRONIKA | March 10, 2023

Postoi video duke shtënë me armë, tre vjet më vonë Policia ia konfiskon atë

KRONIKA | March 10, 2023

Dyshohet se dhunoi një femër, arrestohet vushtrriasi

KRONIKA | March 10, 2023

Sulmoi tre policë në Podujevë, arrestohet i dyshuari

KRONIKA | March 10, 2023

Goditet grupi i kokainës në Athinë, arrestohen katër shqiptarë

KRONIKA | March 10, 2023

Më të lexuarat

KRONIKA | March 09, 2023

Tjetër rast tragjik në Spitalin e Pejës, dyshohet se nga pakujdesia e mjekëve vdiq një i porsalindur

KRONIKA | March 09, 2023

Detaje trondi̇tëse për vdekjen e kadetit të Policisë, aktakuza: Baba e bir ikën nga vendi i ngjarjes, viktima thirri "oj nonë"

KRONIKA | March 08, 2023

Ky është serbi që u arrestua dje si i dyshuar për krime lufte në Kosovë

KRONIKA | March 08, 2023

Një kosovar humb jetën aksidentalisht në Zvicër

KRONIKA | March 08, 2023

Pamje shqetësuese: Pejani publikon videot e momentit kur një person ia vë flakën veturës së tij

KRONIKA | March 09, 2023

Një veturë në veri refuzoi të ndalet, Policia detyrohet të shtijë me armë zjarri

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara © 2010 Portali "Zëri".

redaksia@zeri.info
marketingu@zeri.info
Tel. + 383 38 24 90 71
Tel. + 383 38 22 24 51

Dev: **S.A.P** - Design: **Trembelat**

Ky portal mirëmbahet nga NGB "Zëri" sh.p.k.. Materialet dhe informacionet në këtë portal nuk mund të kopjohen, të shtypen ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër për qëllime përfitimi, pa miratimin e drejtuesve të "Zërit". Për ta shfrytëzuar materialin e këtij portali, obligoheni t'i pranoni Kushtet e përdorimit.